



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:027552

Datë: 10.10.2024

Numri i dokumentit: 06282559

C.nr.211/21

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Shyqri Hoxha, me bashkëpunëtorin profesional A.K. në çështjen juridike kontestimore të paditësit F.A. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson av. A.A. nga Prizreni, kundër të paditurës "BKS" me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson Kompania e Sigurimeve "Sigma", me seli në Prishtinë, për çështjen juridike me objekt kontesti kompensim dëmi material dhe jomaterial, me vlerë të kontestit 20.000,00 euro, jashtë seancës gjyqësore më datë 10 tetor 2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M
NË BAZË TË HEQJES DORË NGA KËRKESËPADIA

REFUZOHET kërkesëpadia paditësit F.A. nga Prizreni, me të cilën ka kërkuar që të "**OBLIGOHET** e paditura B.K.S. me seli në Prishtinë, që më emër të dëmit material dhe jomaterial për të gjitha format dhe llojet e dëmit të ia kompensoi shumën prej 20.000,00 euro, me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e paraqitjes së padisë gjer në pagesën definitive, në afat prej 15 ditësh nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën përfundimtare nën kërcenimin e përmbarimit të dhunshëm, si dhe të obligohet e paditura në pagimin e shpenzimeve të procedurës" **NË TËRESI SI E PABAZUAR.**

A r s y e t i m

Paditësi F.A. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson av. A.A. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate me datë 12.02.2021, ka ushtruar padi kundër të paditurës "BKS" me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson Kompania e Sigurimeve "Sigma", me seli në Prishtinë, për çështjen juridike me objekt kontesti kompensim dëmi material dhe jomaterial, me vlerë të kontestit 20.000,00 euro.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 11 shtator 2024, e cila seancë është mbajtur në mungesë të palës së paditur, i autorizuari i palës paditëse av. A.A. drejtpërdrejtë në procesverbal ka deklaruar se pas pranimit të ekspertizës së punuar nga grupi i ekspertëve dhe meqenëse nuk është konfirmuar lidhja kauzale në mes të lëndimeve dhe pasojave të ndodhura nga aksidenti i datës 07.01.2021,, konsiderojmë se është shuar baza juridike e kërkesëpadisë, andaj heqim dorë nga kërkesëpadia dhe kërkojmë nga gjykata që të nxjerr aktgjykim konform dispozitave të LPK-së.

Gjykata ne kuptim te dispozitave nga neni 149 te Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.211/2021, me datë 10 tetor 2024

Gjyqtari
Shyqri Hoxha

KESHILLE JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, ne afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit ne Prishtinë.